



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. "J&B-NET"
Nr. i biznesit 70722437
Pronare – Fitnete MUJAJ
OK "J@B-NET"
Jabllanicë e Vogël
Pejë
Ref: 1501/107/LIC/ni

VENDIM

për licencimin e Operatorit Kabllor, "J@B-NET"- me seli në Jabllanicë të Vogël, Komuna e Pejës

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Kandidati "J@B-NET", ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operatorë kabllorë, më datën 26 janar 2015.

Arsyetim

3. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
4. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *"për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja"*.
5. KPM kandidatit për licencë për operator kabllor "J@B-NET", i ka përcjellë përmesë e-maili, perveq rregulloreve relevante të KPM-së për aplikim për licencë si: Rregulloren e KPM-së për Dhënien e Licencës (KPM-2013/04), Rregullorën për Nivelin dhe Mënyren e Pagesës së Tarifës për Licencë (KPM-2014/03), Rregullores për Distribuimin Kabllorë të

1/2

Programeve Radio Televizive në Kosovë (CIMC-2007/04) dhe Formën për aplikim për licencë për operator kabllor.

6. KPM vlerëson se, kandidati “J@B-NET”, ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator kabllor, në pajtueshmëri me Nenin 7 të Rregullores CIMC 2007/04.
7. Me Rregulloren CIMC 2007/04 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator kabllor. Prandaj, Zyra Ekzekutive e KPM-se vlerëson se, një operator kabllor mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve, ndërsa kandidati “J@B-NET” ka dorëzuar një listë prej 38 programesh.
8. Kandidati për operator kabllor “J@B-NET” do të ketë të drejtë të bart, në pakon e tij programore, vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje mbi të drejtën e autorit për bartjen e kanaleve përmes rrjetit kabllor.
9. Pas pajisjes me licencë të KPM-së, kandidati për operator kabllor “J@B-NET” mund të sigurojë marrëveshje shtesë për bartjen e programeve në rrjetin e tij kabllor, dhe mund të zgjerojë listën e programeve në të ardhmen. Kandidati “J@B-NET”, obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja për zgjerim të listës programore, sapo t’i ketë siguruar ato.
10. Komisioni vlerëson se “J@B-NET”, ka paraqitur aplikacionin në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04 si dhe me Rregulloren e KPM-së KPM-2013/04.
11. Komisioni vlerëson se, kandidati për operator kabllor “J@B-NET”, ka përmbushur kriteret për kualifikim për t’u pajisur me licencë të KPM-së.

Vendim

12. Në takimin e datës 24 shkurt 2015, Komisioni merr vendim që, kandidatit “J@B-NET” i cili planifikon të operojë në disa fshatra të Komunës së Pejës, t’ia miratojë kërkesën për licencë të KPM-së, për të ofruar shërbime të programeve përmes operatorit kabllorë.

Lëshimi i Vendimit

13. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij. Kandidati mund të fillojë veprimtarinë vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.


Adnan MEROVCI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



26.02.2015

datë